



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2019:269977

Datë: 18.08.2020

Numri i dokumentit: 01067815

P.nr. 307/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të pandehurve F. (D.) B. dhe G. (S.) B. K Klinë, për shkak të veprës penale: Vjedhje pylli , nga neni 349 par 2. 1 të KPRK-së, i akuzuari sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.Nr.2462/2019, të dt. 17.12.2019, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurori i Shtetit Arben Hoti nga Prokuroria Themelore në Pejë dhe të pandehurve të lartëcekur, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më dt. 11.08.2020 , shpalli aktgjykimin, ndërsa me datën, 17.08.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Për të pandehurit:

1.: F. B. i lindur nga prindërit-baba D. dhe nëna Z., e gjinisë B. i lindur me dt...., ne fshatin K Klinë, ku edhe banon, i divorcuar, baba i 4 fëmijëve, ka tr kryer shkollën mesme, me profesion bujk i gjendjes së dobët ekonomike, me nr,...., Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës mbrohet ne liri

2. G. B. i lindur nga prindërit baba S. dhe nëna F., e gjinisë H. i lindur me dt., K Klinë, ku edhe tani banon i martuar baba i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore,i gjendjes se dobët, me profesion ndërtimtar, identifikohet me nr., shqiptar, shtetar i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

JANË FAJTORE

Për shkak se ekziston dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit F. B. dhe G. B.:

Me dt.28.10.2019 rreth orës 23.00 Klinë, nga rajoni ekonomiko-pyjor i cili është nën administrimin e Drejtorisë për Bujqësi, pylltari dhe zhvillim Rural K. Klinë, në bash kryerje, me qëllim të vjedhjes presin trungjet në pyll dhe atë në vëllim të përgjithshëm prej 6m3, në atë mënyrë që të pandehurit një ditë para datës kritike, me dt.27.10.2019 rreth orës 19.00 shkojnë në vendin e lartëcekur nën shoqërinë e një personi të tretë, të pajisur me sharrë motorike dhe dy sopat, përgatisin vendin për të prerë drutë dhe largohen nga vendi i ngjarjes, për çka kthehen natën kritike dhe vazhdojnë prerjen e druve pa e ditur se janë duke u vëzhguar nga pylltarët R.M., R.B., dhe I.Z. dhe kur në momentin kritik pylltarët tentojnë që të kapin të pandehurit, këta të fundit arrijnë të largohen nga vendi i ngjarjes duke lënë aty drutë e prerë.

Më këtë ka kryer veprën penale: vjedhje pyllit në bash kryerje, nga neni 349 par 2 lidhur me par me par 1 dhe neni 31 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4,7,17,41, 46, 50, 51,52 dhe 73 si dhe nenit 349 par.2 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së:

GJYKON

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit:

1. F. B., me dënim Burgu në kohëzgjatje prej shuma (4)muaj, dhe dënim me gjobë shuma në vlerë prej 400 (katërqind) Euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, në qofëse i akuzuari gjatë kohës verifikuese prej 1 (një) viti, nuk do të kryej vepër të re penale.
2. G. B., me dënim Burgu në kohëzgjatje prej shuma (4)muaj, dhe dënim me gjobë shuma në vlerë prej 400 (katërqind) Euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, në qofëse i akuzuari gjatë kohës verifikuese prej 1 (një) viti, nuk do të kryej vepër të re penale.

I.LIROHEN: Të akuzuarit nga shpenzimet e gjykatës, për shkak të gjendjes së doët ekonomike.

II. UDHËZOHET: Pala e dëmtuar Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural K Klinë, qe kërkesën pasurore juridike ta realizoi në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, sipas aktakuzës PP.II.Nr.2462/19, të dt.17,12,2019 ka akuzuar F. B. dhe G. B. qe te dytë nga fshati Gjurgjevik i madh K. Klinë, për shkak të veprës penale ,vjedhje pyllit në bashkëkryerje, nga neni 349 par 2 lidhur 1.dhe nenin 31 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 11.08.2020, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i shtetit Arben Hoti nga Prokuroria Themelore në Pejë, dhe të akuzuarit F.B. dhe G.B.

I pandehuri **F.B.** në seancën e shqyrtimit fillestar, e ka pranuar në fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen, sipas aktakuzës dhe ka shtuar se kërkoi falje dhe premtoj se një gjë e tillë nuk do të përsëritet, meqë është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin, kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj dënim më të butë.

I pandehuri **G.B.** në seancën e shqyrtimit fillestar, e ka pranuar në fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen, sipas aktakuzës dhe ka shtuar se kërkoi falje dhe premtoj se një gjë e tillë nuk do të përsëritet, meqë është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin, kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj dënim më të butë.

Prokurori i Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë, në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e dy të pandehurve të lartëcekur, deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë pasi që pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije të plotë për pasojat e pranimin të fajësisë, pasi që ky pranim është bërë konform dispozitave të KPPRK-së, neni 248.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi se të pandehurit F. dhe G.B. e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht, me liri të plotë nga ana e të akuzuarve, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuar nga Prokurorja e Shtetit.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarve, dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht Prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërtetoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248, par.1, të KPPRK-së dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj Gjykata

konform nenit 248, par.4, të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarve përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale: vjedhje e pylli në bashkëkryerje, nga neni 349 par 2 lidhur me dhe nenin 31 par 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se dy të akuzuarit në aspektin penal-juridik janë përgjegjës, për çka edhe u shpallën fajtorë dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në llojin dhe masën e dënimit, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese për të pandehurin F. dhe G. B. gjeti faktin se të pandehurit, gjatë shqyrtimit fillestar e kanë pranuar në fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, faktin se është hera e parë që kanë rënë në kundërshtim me ligjin, gjendjen e tyre ekonomike-familjare duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethanë rënduese gjykata gjeti dhe pati parasysh dashjen e kryerjes së veprës penale.

I pandehuri F.B. gjykatës ia prezanton dëshminë se është shfrytëzues i ndihmës sociale me nr. Të regj. 32200.

I pandehuri G.B. gjykatës ia prezanton dëshminë se është shfrytëzues i ndihmës sociale me nr. të regj. 20725.

Andaj gjykata ua ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, par.1, të KPRK-së, që të parandaloj kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur, duke marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, aprovoj aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë, për dhënien e dënimit meritor, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Konform dispozitave ligjore të nenit 453 par.4 të KPPRK-sëdy ë pandehurit lirohen nga shpenzimet, dhe paushalli gjyqësor.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463, par.1 dhe 2, të KPRK-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, dhe konform dispozitave ligjore te nenit 25, par.2, 26, par. 2, 297, dhe 365 dhe 470 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA KLINË
P.nr.307/2020, me dt. 17.08.2020

Sekretare juridike:
ShereDesku

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.